



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 28 korrik 2020
Nr. Ref.:RK 1592/20

VENDIM PËR REFUZIMIN E KËRKESË

në

rastin nr. KI93/19

Parashtrues

Valton Karaxhiu

Vlerësim i kushtetutshmërisë së akteve të pasfecifikuara

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Valton Karaxhiu, me vendbanim në Komunën e Prizrenit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).
2. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që e përfaqëson L.B dhe A.B.

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesi i kërkesës konteston një tërësi aktesh në mënyrë të përgjithshme, pa arritur të specifikojë aktin konkret të autoritetit publik.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara, përmes së cilave pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 36 [E Drejta e Privatësisë] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] e 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 11 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 12 qershor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
8. Më 29 korrik 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai sqarimin se (i) cilin vendim e konteston në Gjykatë duke e bashkëngjitur atë; (ii) të qartësojë se kush është parashtrues, apo nëse e përfaqëson dikë të sjellë autorizimin respektiv.
9. Më 16 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës përmes postës elektronike, dorëzoi në Gjykatë plotësimin e kërkesës ku përsëri nuk specifikoi aktin konkret të cilin e konteston. Ai në këtë plotësim theksoi që prindi i tij ka ndërruar jetë, rrjedhimisht, ai është pronar i ri i banesës.
10. Më 20 dhjetor 2019, Gjykata përsëriti kërkesën për informata/dokumente shtesë dhe kërkoi nga ai sqarimin se (i) cilin vendim e konteston në Gjykatë duke e bashkëngjitur atë; (ii) të qartësojë se kush është parashtrues, apo nëse e përfaqëson dikë të sjellë autorizimin përkatës.
11. Më 26 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës përmes postës elektronike, dorëzoi në Gjykatë plotësimin e kërkesës ku përsëri nuk e sqaroi se cilin akt konkret e konteston, mirëpo i njëjti theksoi se po e dorëzon 'Vendimin përmbarues të

Gjykatës Themelore në Prizren’ – i cili i përmban të gjitha vendimet të cilat parashtruesi i konteston.

12. Më 9 korrik 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Çështja e parashtruar ka të bëjë me kontestimin e pronësisë së një banese në lagjen Ortakoll në Prizren, e cila fillimisht përmes kontratës për shfrytëzimin e banesës i ishte dhënë Mehmet Karaxhiut (i ati i parashtruesit), përmes vendimit nr. 1063/1 të 5 nëntorit 1982 OBPB “Ndërtimi”.
14. Më 20 prill 1994, Gjykata Komunale në Prizren (Në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Komunale) përmes Aktgjykimit [C.nr.182/94] aprovoi kërkesëpadinë e ndërmarrjes “Ndërtimi” përmes së cilës e prishi kontratën mbi dhënien e banesës në shfrytëzim dhe obligoi Mehmet Karaxhiun që të shpërngulet nga banesa dhe të njëjtën ta dorëzojë tek ndërmarrja “Ndërtimi”.
15. Më 29 shtator 1994, Gjykata e Qarkut në Prizren, përmes Aktgjykimit [Ac.nr.497/94] e vërtetoi Aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Komunale.
16. Më 25 nëntor 1994, ndërmarrja “Ndërtimi” përmes vendimit [nr.175/1] vendosi ndarjen e banesës në shfrytëzim për E.V. me atë që ai të lidh kontratën mbi shfrytëzimin e banesës.
17. Në bazë të shkresave të lëndës, përkatësisht në arsyetimin e Aktgjykimit [C.nr.165/03] të 16 nëntorit 2004 të Gjykatës Themelore në Prizren, në faqen 2 të tij rezulton që me 20 maj 1996, Gjykata Komunale përmes vendimit [Ndr.nr.131/93] vendosi që Mehmet Karaxhiu bëhet bartës i së drejtës banesore të banesës kontestuese, me atë që të paguajë në tërësi çmimin e shitblerjes. Mirëpo ai nuk kishte parashtruar prova se e ka paguar çmimin e shitblerjes së banesës kontestuese –në bazë të së cilës do të bëhej pronar.
18. Nga ana tjetër, pasi që edhe pas ndarjes së banesës përmes vendimit [nr.175/1] të 25 nëntorit 1994 për E.V nga ndërmarrja “Ndërtimi”, nuk ishte lidhur kontrata për shfrytëzimin e banesës ndërmjet tyre, më 17 shtator 1998, Gjykata Komunale në Prizren përmes vendimit [Ndr.nr.55/97] vendosi pranimin e propozimit të E.V për zëvendësimin e kontratës së shitblerjes së banesës përmes vendimit të asaj gjykate dhe obligoi atë (E.V) për pagesën e çmimit të shitblerjes. Më 6 prill 1998, E.V e bën pagesën e çmimit të shitblerjes së banesës dhe në bazë të saj e fiton të drejtën e pronësisë në banesën e kontestuar.
19. Më 16 nëntor 2004, Gjykata Komunale në Prizren përmes Aktgjykimit [C.nr.165/03] aprovoi kërkesën e E.V. dhe e obligoi Mehmet Karaxhiun që të lirojë banesën dhe të njëjtën t’ia dorëzojë paditësit në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohej që E.V është bërë pronar legjitim i banesës përmes vendimit [Ndr.nr.55/97] të Gjykatës Themelore në Prizren, prandaj përderisa parashtruesi i kërkesës

gjendet në posedim faktik të saj, atëherë i njëjti detyrohet t'ia dorëzojë pronarit legjitim.

20. Sipas shkresave të lëndës, parashtruesi i kërkesës prezanton edhe një Certifikatë të rastit [nr. DS007317] të 7 majit 2008, të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore i cili vetëm specifikon që vendimi i Komisionit për Çështje Pronësore dhe Banesore [HPCC/REC/74/2006/C] është final. Kjo certifikatë nuk sqaronte se cili është vendimi në fjalë, rrjedhimisht parashtruesi ka dështuar ta plotësojë kërkesën e tij me dokumentet e kërkuara nga Gjykata.
21. Gjithashtu në bazë të shkresave të lëndës, parashtruesi i kërkesës prezanton edhe një dokument të Agjencisë Kosovare të Pronës [nr. i referencës: 729/09/bi] i titulluar "Statusi i kërkesës DS007317" i 6 qershorit 2009, i cili gjithashtu thekson që Vendimi i Komisionit për Çështje Pronësore dhe Banesore është final. Kjo shkresë nuk sqaronte se cili është vendimi në fjalë, rrjedhimisht parashtruesi ka dështuar ta plotësojë kërkesën e tij me dokumentet e kërkuara nga Gjykata.
22. Sipas shkresave të lëndës për aq sa ishte e mundur të kuptohej, më 19 mars 2014, parashtruesi i kërkesës dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit lidhin kontratë mbi shitblerjen e banesës së kontestuar. Parashtruesi ka prezantuar vetëm fagen e parë të kësaj kontrate, rrjedhimisht parashtruesi ka dështuar të plotësojë kërkesën e tij me dokumentet relevante të kërkuara nga Gjykata.
23. Më 14 dhjetor 2015, përmbaruesi privat, Enis Hoxha, përmes Propozimit [P.nr.320/2015] për përmbarim, urdhëroi përmbarimin e Aktgjykimit [C.nr. 165/03] të 16 nëntorit 2004 të Gjykatës Komunale, përmes së cilit Mehmet Karaxhiu ishte i obliguar që të lironte banesën.
24. Ndaj Urdhrit të lartpërmendur për përmbarim, Mehmet Karaxhiu ushtron prapësim, të cilin e refuzoi si të pabazuar Gjykata Themelore në Prizren përmes Aktvendimit [P.nr. 320/2015] të 9 qershorit 2016.
25. Më 20 qershor 2016, Mehmet Karaxhiu ushtron prapësim ndaj Aktvendimit të lartpërmendur, të cilin e refuzoi si të pabazuar Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr. 2489/2016] të 3 korrikut 2017. Rrjedhimisht, Aktvendimi [P.nr. 320/2015] i 9 qershorit 2016, i Gjykatës Themelore, u bë i plotfuqishëm me 10 gusht 2017.
26. Më 8 gusht 2016, Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prizren përmes Aktvendimit [07-027-84052/B] aprovoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për bartjen e pronësisë nga ana e prindërve të tij tek ai si pronar i vetëm i banesës e cila ishte bërë përmes kontratës së dhurimit.
27. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës bën shitjen e banesës L.B.
28. Në bazë të shkresave të lëndës, vërehet se Mehmet Karaxhiu përmes Aktgjykimit [P.nr.1107/14] të 11 nëntorit 2015 të Gjykatës Themelore në Prizren, ishte (i) shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve, (ii) ishte dënuar me kusht, duke vërtetuar që dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti nuk do të ekzekutohej

nëse i akuzuari gjatë kohës së verifikimit prej 2 vitesh nuk kryen vepër tjetër penale; (iii) të paguajë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50 EUR dhe (iv) i dëmtuari E.V për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil. Më 24 dhjetor 2015, ndaj Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore kishte parashtruar ankesë Mehmet Karaxhiu me propozimin e ndryshimit ose të anulimit të Aktgjykimit të atakuar. [Shënim: Aktgjykimi [P.nr.1107/14] i 11 nëntorit 2015, i Gjykatës Themelore në Prizren është referuar në bazë të ankesës kundër këtij Aktgjykimi, pasi që parashtruesi ka dështuar të plotësojë kërkesën e tij me dorëzimin e këtij Aktgjykimi si dhe me epilogun e ankesës në Gjykatën e Apelit, dokumente këto të kërkuara nga Gjykata në kuadër të dokumenteve relevante].

29. Përfundimisht, më 13 shkurt 2019, përmbaruesi privat, Enis Hoxha, përmes konkluzionit [P.nr.320/2015] urdhëron N.K (nëna e parashtruesit) dhe L.B që të lirojnë banesën në afat prej 7 (shtatë) ditësh dhe të njëjtën t'ia dorëzojnë në pronësi dhe posedim kreditorit të përmbarimit E.V, në të kundërtën organi përmbarues të njëjtën do ta liroj dhe zbrazë nga njerëzit dhe sendet.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes akteve të lartë theksuara, atij i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 36 [E Drejta e Privatësisë] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.
31. Parashtruesi i kërkesës pretendon që ai ishte pronar legjitim i pronës së kontestuar, të cilën e kishte fituar në bazë të kontratës së dhurimit nga prindërit e tij, të cilën e regjistroi më 8 gusht 2016, në Agjencinë Kadastrale të Kosovës në Prizren.
32. Parashtruesi më tej pretendon se lidhur me rastin e kontestimit të pronësisë së banesës “janë disa lëndë nga gjykata Themelore në Prizren me numra të të lëndëve si në vijim: “Aktvendimi [Ndr. Nr. 55/97] date 17.02.1998, Aktgjykimi [C.nr. 165/05] datë 16.11.2004, Aktgjykimi [C. nr. 165/03] dhe Aktgjykimi [CP nr. 1335/2015] datë 25 08 2015.”
33. Ai pretendon se përmes marrjes së vendimit gjyqësor pa marrë parasysh “vendimin final të Komisionit për çështje Pronësore dhe banesore”, ai është diskriminuar qëllimisht. Për më tepër, duke pasur parasysh faktin se vendimet e Komisionit ishin të detyrueshme dhe nuk ishin objekt shqyrtimi nga asnjë institucion gjyqësor apo administrativ në Kosovë, atij i është cenuar edhe e drejta për Gjykim të Drejtë.
34. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se L.B.-së, që sipas tij është pronare e re e banesës, i është cenuar privatësia me rastin e kontrollimit të paautorizuar të banesës nga përmbaruesi privat, Enis Hoxha.
35. Përfundimisht, parashtruesi pretendon se L.B.-së i është cenuar e drejta e pronës të cilën tashmë parashtruesi e konsideron si pronare të banesës.

Pranueshmëria e kërkesës

36. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
37. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

38. Gjykata gjithashtu i referohet neneve 21, 22.4 dhe 48 të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 21 [Përfaqësimi]

“Palët gjatë procesit para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala.”

Neni 22 [Procedimi i kërkesës]

4. Nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Gjyqtari raportues ka të drejtë të kërkojë prova shtesë, nëse kjo është e nevojshme për të vlerësuar lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

39. Për më tepër, Gjykata merr në konsideratë rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës, që parasheh:

“(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor;

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.”

(3) Nëse pala ka përfaqësues, përfaqësuesi dorëzon në Gjykatë bashkë me kërkesë, autorizim të vlefshëm.”

40. Gjykata gjithashtu merr në konsideratë rregullin 35 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, që parasheh:

Rregulli 35 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës]

(5) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze.

41. Sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara nga nenet 24, 31, 36 dhe 102 të Kushtetutës.
42. Gjykata rikujton që kërkesa është dorëzuar nga Valton Karaxhiu i cili deklaron që e përfaqëson veten e tij dhe pretendon të përfaqësojë L.B dhe A.B., nga Prizreni. Gjykata vëren se sa i përket përfaqësimit, parashtruesi i kërkesës nuk ka bashkangjitur në shkresat e lëndës një autorizim të vlefshëm për Gjykatën.
43. Në vlerësimin e përmbushjes së këtyre kriterëve të pranueshmërisë, Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës (i) nuk ka qartësuar kontestimin e ndonjë akti të ndonjë autoriteti publik; (ii) nuk ofroi kronologjinë e vendimeve që i konteston; (iii) nuk e ka sjellë autorizimin për përfaqësim në Gjykatë; dhe (iv) nuk arriti të bashkëlidhë aktet të cilat përgjatë kërkesës së tij i konteston si në vijim: “Aktvendimi [Ndr. Nr. 55/97] i 17 shkurtit 1998; Aktgjykimi [C. nr. 165/03], Aktgjykimi [CP nr. 1335/2015] i 25 gushtit 2015”.
44. Meqenëse parashtruesi i kërkesës kundërshton një mori aktesh të instancave të ndryshme, pa arritur të specifikojë aktin konkret të autoritetit publik të cilin ai pretendon ta kundërshtojë, Gjykata kujton se parashtruesi i kërkesës është i detyruar të mbështesë me dokumente të vlefshme këto pretendime të tij dhe të njëjtat t’ia ofrojë Gjykatës.
45. Gjykata para së gjithash rikujton, se në rastin konkret sipas nenit 22 të Ligjit, ajo në dy raste i ka kërkuar parashtruesit të kërkesës “të plotësojë kërkesën e tij për të sqaruar para Gjykatës aktin konkret të autoritetit publik që e konteston; të sigurojë dokumentet e nevojshme të cilat mund të jenë të nevojshme për Gjykatën dhe të bashkëngjës autorizimin që dëshmon se përfaqëson persona të caktuar në Gjykatë.”
46. Mosdorëzimi i autorizimit të vlefshëm në Gjykatë i pamundëson Gjykatës shqyrtimin e një kërkesë në pajtim me nenin 21 të Ligjit dhe rregullin 32 (2)(c) të Rregullores së punës, për sa i përket pretendimit për përfaqësim të L.B. dhe A.B.
47. Në këtë aspekt, Gjykata konkludon se kërkesa është e paplotë dhe nuk është e qartësuar sepse parashtruesi i kërkesës si përfaqësues i pretenduar i L.B. dhe

A.B. nuk kishte dorëzuar në Gjykatë autorizimin e vlefshëm për përfaqësimin e palëve të cilët ai pretendon se i përfaqëson para Gjykatës (shih rastet e Gjykatës nr. KI23/18, parashtrues, *Ismet Kërçagu*, si përfaqësues i pretenduar i A. K., M. K., B. K., F. K. dhe A. K., Vendim për refuzim të kërkesës, i 7 shkurtit 2019; nr. KI16/18, parashtrues, *Sahit Musa*, si përfaqësues i pretenduar i K. N., Vendim për refuzim të kërkesës i 31 dhjetorit 2018; nr. KI30/18, parashtrues, *Sahit Musa*, si përfaqësues i pretenduar i N. H., XH. H. dhe S. H., Vendim për refuzim të kërkesës, i 10 majit 2018 dhe rastin KI203/18, parashtrues, *Afrim Salihu* si përfaqësues i pretenduar i L. K., Vendim për refuzim të kërkesës i 26 qershorit 2019).

48. Më tej, Gjykata konstaton se në bazë të përgjigjeve të pranuara, parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur t'i japë sqarimet e kërkuara dhe se nuk ka arritur t'i përcjellë aktet të cilat i konteston përgjatë tekstit të kërkesës së tij, me theks të veçantë, ai nuk arriti të (i) përcaktojë aktin konkret të autoritetit publik që e konteston para Gjykatës; (ii) ofrojë kronologjinë e vendimeve që i konteston; dhe (iii) nuk arriti të bashkëlidhë aktet të cilat përgjatë kërkesës së tij i konteston si në vijim: "*Aktvendimi [Ndr. Nr. 55/97] i 17 shkurtit 1998; Aktgjykimi [C. nr. 165/05], Aktgjykimi [CP nr. 1335/2015] i 25 gushtit 2015*".
49. Gjykata thekson se nuk është gjykatë e mbledhjes së fakteve dhe barra e provës i mbetet parashtruesit të kërkesës i cili nuk i plotësoi kërkesat procedurale të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës (Shih, për shembull, rastin e Gjykatës KI192/19, me parashtrues *Naser Shala*, Vendim për Refuzim të Kërkesës, i 23 marsit 2020, paragrafi 31; KI03/15, Parashtruesi *Hasan Beqiri*, Vendimi për hedhje poshtë të kërkesës i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 5 qershor 2015, paragrafi 21).
50. Gjykata konsideron se nuk mund t'i marrë për bazë pretendimet e parashtruesit, pa dokumente dhe prova materiale mbështetëse, në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit dhe me rregullat 32 (2) (h) dhe 35 (5) të Rregullores së punës.
51. Prandaj, Gjykata vëren se, përveç kërkesës së tij të përgjithshme dhe abstrakte, parashtruesi i kërkesës, nuk i ka parashtruar Gjykatës informacionin dhe dokumentet e kërkuara të aktit të kontestuar, edhe pse Gjykata e ka kërkuar këtë nga ai dy herë.
52. Në përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa nuk i plotëson kërkesat procedurale për shqyrtim të mëtejshëm të parashikuar nga rregulli 35 i Rregullores së punës. Megjithatë parashtruesi i kërkesës nuk e ka qartësuar aktin konkret të cilin e konteston para Gjykatës dhe nuk ka paraqitur dokumentet e nevojshme të kërkuara, si dhe nuk dorëzoi autorizimin e vlefshëm në Gjykatë sa i përket pretendimit për përfaqësim të L.B. dhe A.B. kërkesa duhet të refuzohet në procedurë të shkurtër, në përputhje me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 32(2)(c) dhe (h), 35 (5) dhe 59 (3) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 9 korrik 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi